

GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT, në Seancën e përgjithshme të mbajtur më 25.05.2022, në bazë të nenit 37 paragrafi (1) nënpika 1 nga Ligji për gjykatat (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 58/2006...96/2019), nxori këtë:

## K O N K L U Z I O N

Iniciativa Su-03.nr.927/21 të datës 20.12.2021, e parashtruar nga Kryetari i Sektorit gjyqësor për çështje kontestuese të Gjykatës Themelore Civile Shkup, të dorëzuar përmes Kryetarit të Gjykatës Themelore Civile Shkup, për miratim të mendimit juridik parimor, NUK PRANOHET.

## A r s y e t i m

Në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga ana e Kryetarit të Sektorit gjyqësor për çështje kontestuese Shkup, të Gjykatës Themelore Civile është dorëzuar njoftim – kërkesë për shqyrtimin e çështjes juridike në vazhdim nga ana e Seancës së përgjithshme të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në fakt, në kërkesë është theksuar se në seancën e mbajtur të Sektorit gjyqësor për çështje kontestuese të gjykatës së shkallës së parë është paraqitur nevoja lidhur me zbatimin e nenit 98 paragrafi (3) në lidhje me nenin 101 paragrafi (1) të Ligjit për procedurë kontestuese, lidhur me rregullimin e padisë në kontest ku e paditura është RMV – ja, M., për prishjen e vendimeve për shkak se gjatë shqyrtimit paraprak të padisë është konstatuar se në padinë nuk është theksuar përfaqësuesi ligjor i të paditurit, që ka qenë e domosdoshme të jetë i theksuar sipas nenit 98 paragrafi (3) nga Ligji i përmendur, se nuk ka qenë i shënuar numri unik amë i subjektit të regjistrit, posaçërisht kur bëhet fjalë për të dhënë publike që detyrimisht shënohet në regjistrin tregtar. Për shkak të së theksuarës, se në padinë e parashtruar për lëndën e asaj gjykate RO-2341/20 nuk kanë qenë të përfshira të gjitha të dhënat sipas dispozitës ligjore të theksuar dhe se padia është hedhur poshtë, por gjykata e shkallës së dytë me aktvendim ROZH- 1143/20 të datës 20.10.2021, e ka abroguar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe lëndën e ka kthyer në ri vendimmarrje me sugjerim të paraparë në Ligjin për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore dhe karakteri i definuar i subjektit juridik, më saktë se nuk mund të pranojë se dispozita e nenit 98 të Ligjit për procedurë kontestuese ka të bëjë edhe me këtë subjekt kur paraqitet si palë e paditur, për arsye se nuk bëhet fjalë për person juridik të themeluar sipas Ligjit për shoqëritë tregtare ose me ndonjë ligj tjetër në bazë të së cilës kryen veprimtari të regjistruar, subjektiviteti juridik i të cilit për shkak të ekzistimit të kushteve për procedimin e mëtejshëm duhet që të kontrollohet nëpërmjet dorëzimit së të dhënave nga Regjistri Qendror. NUAS (numri unik amë i subjektit) se është i vetmi dhe i pandryshueshëm, numër identifikues i papërsëritur i çdo subjekti dhe është i lidhur me NUT (numri unik tatimor), që është identifikues i të dhënave për obliguesin tatimor, por që ka të bëjë me personat fizik dhe juridik që kryejnë veprimtari ose profesion të regjistruar, ndërsa të dhëna në suaza të kompetencës së tij dorëzojnë organet shtetërore sipas kompetencës së tyre, ku

mundësojnë shfrytëzimin pa pengesë së të dhënave të tyre në Regjistrin Qendror. Në të njëjtën kohë, se për Ministrinë e RMV, fakt i vërejtur është se bëhet fjalë për organ që është i rregulluar me Ligjin për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore, prej aty se gjykata e shkallës së parë e ka zbatuar gabimisht dispozitën e nenit 98 paragrafi (3) të LPK kur padinë e ka konsideruar si të parregullt.

Sipas parashtresit të kërkesës nga dispozita ligjore e theksuar nuk ka buruar përjashtimi sa i përket të dhënave që duhet t'i përmbajë padia kur paditësit janë organe të administratës shtetërore, konkretisht ministritë, në mënyrë që parashtresi i kërkesës ka vlerësuar se duhet që me këtë njoftim – kërkesë të njoftohet dhe të shqyrtohet kjo çështje në Seancën e përgjithshme të Gjykatës Supreme të RMV. Në shtojcë janë dorëzuar: padia e paditësit K.I.C nga S., kundër të paditurit RMV – M. S., me përfaqësues ligjor të theksuar Avokatura Shtetërore e RMV, aktvendim të Gjykatës Themelore Civile RO-2341/20 të datës 30.07.2020 dhe aktvendim të Gjykatës së Apelit Shkup ROZH-1143/20 të datës 20.10.2021.

Duke u nisur nga e theksuara më sipër në kërkesën dhe vendimet e bashkëngjitura konstatohet se nuk ekziston praktikë e ndryshme gjyqësore në zbatimin e nenit 98 dhe nenit 101 të Ligjit për procedurë kontestuese, në konteste ku si e paditur është Republika e Maqedonisë së Veriut – MPB ose ndonjë ministri tjetër pranë Qeverisë së RMV. Ligji për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore (“Gazeta Zyrtare e RM” numër 44/02, numër 82/08, numër 167/2010, numër 51/2011, numër 96/2019 dhe numër 110/2019) na udhëzon në regjistrimin e organit të administratës shtetërore, përkatësisht na udhëzon në dispozitat e Ligjit për shoqëri tregtare ose ndonjë ligj tjetër në bazë të së cilit bëhet evidenca e të dhënave nga Regjistri Qendror të RMV. Njëkohësisht, se në rastin e këtillë kur bëhet fjalë për palën e paditur - ministria kompetente pranë Qeverisë së RMV, subjektiviteti juridik i organit të theksuar shtetëror është në rregull dhe me Kushtetutën e RMV, krahas me Ligjin për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore.

Nga shumë kërkesat e bëra të praktikës gjyqësore të kësaj gjykate nuk është konstatuar praktikë e ndryshme gjyqësore, duke marrë parasysh se parashtresi i njoftimit – kërkesës nuk ka dorëzuar praktikë të ndryshme gjyqësore lidhur me zgjidhjen e çështjes juridike të determinuar, Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, vendosi si në kumtimin e këtij Konkluzioni.

Gjykata Supreme e  
Republikës së Maqedonisë së Veriut  
Seanca e përgjithshme

GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT, në Seancën e përgjithshme të mbajtur më 25.05.2022, në bazë të nenit 37 paragrafi (1) nënpika 1 të Ligjit për gjykatat (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 58/2006...96/2019), nxori këtë:

## K O N K L U Z I O N

Iniciativa Su-03.nr.192/22 të datës 14.03.2022, të parashtruar nga avokatja Kristina Stojanovska nga S., për miratim të mendimit juridik parimor NUK MIRATOHET.

## A r s y e t i m

Në Seancën e përgjithshme të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Iniciativë për miratim të mendimit juridik parimor parashtror Kristina Stojanovska, avokate nga Shkupi, për këtë çështje juridike:

“Nëse NP H.K. S. e themeluar nga Qyteti S., si dhënës i shërbimit komunal, pa ekzistimin e marrëveshjes së lidhur me shfrytëzuesin e shërbimit komunal – person juridik me të cilin rregullohen të drejtat e njëri tjetrit dhe obligimet për realizimin e shërbimit komunal, grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave komunale dhe lloje të tjera të mbeturinave të parrezikshme në kuptim të nenit 4 pika 5, nenit 18 paragrafi (1) të Ligjit për veprimtari komunale dhe nenit 43 paragrafi (8) dhe nenit 121 paragrafi (4) të Ligjit për menaxhimin e mbeturinave, dhe pa e realizuar shërbimin është me fuqi të ligjit njëri nga subjektet e vetëm të autorizuar juridik që mund të lëshojë fatura mujore – fatura të shfrytëzuesit, me të cilin nuk ka lidhur marrëveshje dhe të kërkojë pagesë të shërbimit që nuk e ka realizuar”.

Parashtruesi i iniciativës thekson se, arsyeja për parashtrimin e të njëjtës është mos harmonizimi i praktikës gjyqësore në suaza të këshillave të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, kur vendoset për një çështje të njëjtë juridike dhe gjendje të ngjashme faktike. Në fakt, nga kjo gjykatë janë miratuar aktgjykime të ndryshme për të njëjtën bazë juridike që kanë të bëjnë me një subjekt të njëjtë juridik – paditës NP.H.K. S. - dhënës i shërbimeve komunale, për borxh me kundërshtim të parashtruar nga debitori – persona juridik – shfrytëzues të shërbimeve, grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave komunale kundër aktvendimit për lejen për realizimin në bazë të dokumentit autentik.

Në shtojcë të iniciativës së bazuar të saj, parashtruesja i referohet tre vendimeve të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut: Rev1 nr.207/2018 të datës 05.03.2019, Rev1.nr.41/20 të datës 01.12.2020 dhe Rev1 nr. 119/21 të datës 09.12.2021. Sipas parashtrueses në dy vendimet Rev të sipërcituara është shprehur një qëndrim identik: se lidhja e marrëveshjes për grumbullimin, transportimin dhe deponimin e mbeturinave komunale ndërmjet paditësit NP H.K. S. si dhënës i shërbimeve dhe të paditurit – shfrytëzues i shërbimit (subjekt juridik) është obligim ligjor dhe nuk do të thotë se me automatizëm, pa marrëveshje të lidhur, paditësi ka pasur të drejtë të kompensimit për shërbim që nuk e ka

realizuar. Në vendimin e tretë Rev1 nr.119/21 të datës 09.12.2021 sipas parashtrueses, ky qëndrim është ndryshuar në atë mënyrë që krijohet praktikë gjyqësore jo e barabartë për këtë çështje juridike. Në fakt, në këtë vendim të tretë këshilli i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut ka shprehur qëndrim se paditësi është NP H.K. S., që veprimtarinë e tij e realizon në bazë të Vendimit për mënyrën dhe procedurën e mirëmbajtjes së pastërtisë publike, grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave të forta dhe komunale të rajonit të Qytetit S., si dhe Programin për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave të forta dhe komunale të rajonit të Qytetit S., pasi që shërbimin komunal që e bën paditësi është obligues dhe i detyrueshëm, dhe nuk paraqet marrëdhënie obliguese, dhe të njëjtën mund ta bëjë vetëm personi që krahas lejes nga Ministria duhet të ketë edhe autorizim nga Qyteti S.

Pas shqyrtimit me vëmendje të iniciativës së sipër theksuar dhe të materialit të dorëzuar ndaj të njëjtës, Seanca e përgjithshme konstaton se nuk ka praktikë të ndryshme gjyqësore ndërmjet këshillave në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut për këtë çështje juridike. Kjo për arsytet si në vazhdim:

Në dy vendimet e para të revizioneve Rev1 nr.207/2018 të datës 05.03.2019 dhe Rev1. nr.41/20 të datës 01.12.2020, që sipas iniciatorit janë në rregull, paditës është NP K. H. S., ndërsa i paditur është SHA.....S.D. P., për borxhin sipas faturave. Në të dyja vendimet revizioni i paditësit është refuzuar si i pabazë, ngase nga gjendja faktike e konstatuar nga gjykatat më të ulëta rezulton se ndërmjet paditësit dhe të paditurit në kohën e lëshimit të faturave në fjalë, nuk ka pasur marrëveshje të lidhur për rregullimin e mënyrës së realizimit të shërbimeve për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave, dhe për të cilin shërbim i padituri është obliguar për ato fatura. Përveç kësaj, paditësi nuk ka bashkëngjitur prova se ka vendosur enë për grumbullimin e mbeturinave komunale, por as nuk është dëshmuar se paditësi e ka mbledhur dhe transportuar mbeturinën komunale nga hapësirat afariste në pronësi së të paditurit në kompleksin afarist të fabrikës G. në S. Kjo aq më tepër, pasi që nga provat rezulton se i padituri me shpenzimet e tij, vet e ka grumbulluar mbeturinën dhe të njëjtin e ka transportuar në gropë mbeturinash të qytetit D. Lidhur me faturat në fjalë, i padituri ka kundërshtuar me prova me shkrim dhe të njëjtat ia ka kthyer të paditurit. Këto rrethana rezultojnë edhe nga këqyrja në vendin e ngjarjes nga gjykatat, nga të cilat është konstatuar se paditësi nuk ka vendosur kontejnerë për grumbullimin e mbeturinave të i padituri, dhe se kontejnerë për grumbullimin e mbeturinave ka vendosur vet i padituri, përderisa nga prova – Listë evidentuese për hyrje dhe dalje të automobilave në rrethin e kompleksit G. është konstatuar se paditësi ka hyrë në kompleksin afarist dhe i ka grumbulluar dhe transportuar mbeturinat vetëm nga objekti afarist ku ka pas të vendosura kontejnerë të tij, më saktë nga objekti afarist në të cilin ka zhvilluar veprimtarinë e saj firma G.

Në këto dy vendime, po ashtu është theksuar se, lidhja e marrëveshjes është obligim ligjor, por ajo nuk do të thotë se me automatizëm që nëse nuk bëhet marrëveshje e tillë, doemos që të paguhet kompensimi i shërbimit nëse shërbimi nuk është bërë. Përveç kësaj, paditësi si NP që ka obligim ligjor që t'i grumbullojë dhe transportojë mbeturinat komunale, para se t'i dorëzojë faturat duhet të kryejë shërbimin që sipas ligjit është i obliguar ta kryejë

Do thotë se në të dyja këto vendime theksi është vënë në atë se a është kryer shërbimi apo jo, e jo për atë se a është lidhur marrëveshje ose nuk është lidhur për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave komunale.

Në vendimin e tretë Rev1 nr.119/21 të datës 09.12.2021, që sipas iniciatorit çon në praktikë të ndryshme gjyqësore ndërmjet këshillave në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, paditës është NP H.K. S., ndërsa i paditur është Shoqëria....A. S. DOO eksport – import S., për borxhin në vlerë në lartësi prej 885.021,00 denarë. Me këtë vendim, revizioni i të paditurit është refuzuar si i pabazë për arsye se nga gjykata më e ulët është konstatuar se paditësi është ndërmarrje publike e autorizuar, që veprimtarinë e saj e kryen në bazë të Vendimit për mënyrën dhe procedurën për mirëmbajtjen e pastërtisë publike, grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave komunale teknike dhe të forta të rajonit të Qytetit S., si dhe Programit për grumbullimin, transportimin dhe deponimin e mbeturinave komunale teknike dhe të forta, program ky të cilin çdo vit e sjell Qyteti S., pasi që ky shërbim që e bën paditësi është obligues dhe mund ta bëjë vetëm person juridik që ka leje nga Ministria dhe autorizim nga Qyteti S. Në rastin konkret, i padituri ka poseduar marrëveshje të lidhur për shërbim me E.K.DOOEL B., person juridik që ka pasur leje për kryerjen e aktivitetit vetëm nga Ministria, por nuk ka poseduar leje edhe nga Këshilli i Qytetit S., për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave komunale dhe lloje tjera të mbeturinave të parrezikshme në territorin e Qytetit S. Përveç kësaj, gjykata më e ulët ka konstatuar edhe atë se paditësi nuk i ka ngritur mbeturinat që i ka bërë i padituri, ngase i padituri nuk e ka lejuar ta bëjë atë, për arsye se ka pasur marrëveshje të lidhur për këtë shërbim me E.K. DOOEL B. I padituri nuk ka dëshmuar se nuk e ka penguar paditësin që të kryejë obligimin e tij ligjor në periudhën kontestuese.

Nga këtu, rezulton se në këtë vendim të tretë theksi është vënë përsëri në të njëjtën rrethanë se a është kryer shërbimi apo jo, dhe nëse nuk është kryer për çfarë arsye, dhe jo për atë se a është lidhur marrëveshje ose jo për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave.

Duke marrë parasysh të sipër theksuarën, se ndërmjet këshillave në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk ka praktikë të ndryshme gjyqësore për këtë çështje juridike, Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, vendosi si në kumtimin e këtij Konkluzioni.

Gjykata Supreme e  
Republikës së Maqedonisë së Veriut  
Seanca e përgjithshme